

E DIELA V E KRESHMEVE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Përhëmbëllta të Triodit më Tingëllin II:

PAS IKOS TU EFRATHA

S' hynje në kishë dot, nga fajet dhe mëkatat, po passi u-pendove, Parajsën e fitove, dhe famën e Shenjtorëve.

Shkove drejt në Jordan, si Pagëzori rrojte, dhe trupin e mundove, kurorën e fitove, në sheshin e murgeshave.

Lutu dhe nërmjeto, për çdo besnik pa reshtur, o Nënë Oshënare, Mari Egiptiane, përpara Zotit Jesu Krisht.

LAVDI. Forca e Kryqit tënt o Krisht, bëri një çudi të madhe, se mëkatarja u-bë murgeshë; e hodhi tutje dobësinë, dhe lëftoj kundër Satanit trimërisht; përandaj e fitoj kurorën e triumfit, edhe nërmjeton për shpirtet tona.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI, T. II. I preve pasionet e egëra të trupit, me shpatën e përkorës; i pushove mejtimet e paudha me heshtjen e ashkëtizmës; e vadite shkretëtirën me lote, dhe na solle pemët e pendimit; përandaj o Nënë Oshënare, e kremtojmë kujtimin tënt.

Tania e Tingëllit, Përlëshorja e Tingëllit, pastaj:

PERLESHORJA E SHEN MARISE, T. T. IV.

TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si rrëke, shkretëtirën e that' e vadite për lërim, dhe me vajtim dhe psherëtim, gjer një qint herë pemë mblodhe për çdo mundim; u-çfaqë pra si yll, dhe e ndriçove botën me çdo çudi, Mari e Shentjë Oshënare me nam, lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

Pastaj këndohet Hyjlindësorja e Tingëllit Tërthor IV:

TANI. Ti që linde për ne prej Virgjëreshës, dhe durove kryqësimin o i Mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje, dhe u-ngjalle si Perëndi, mos i harro ata që gatove me dorën tënde, po tregoje njeridashjen si mëshirëplot, prit-e Nënë Hyjlindëse, që nërmjeton për ne, dhe shpëtoje o Shpëtimtar, popullin e dëshpëruar.

SHKURTORJA, T. II.

PAS I PARTHENOS SIMERON

Mëkatarja me vajtim, dhe me pendim u-ndryshua, edhe nus' e Zotit Krisht, u-çfaq me anë t' ashkëtizmës, dhe u-be, si një Engjëll në shkretëtirë, dhe me Kryq, përmbysi djallin dhe pasionet; hyre pra në Mbretërinë, o Nën' oshënare, Mari e ndriçime.

SHTEPIA

Të lavdërojmë me këngë, o shqerrë dhe bijë e Krishtit, o Mari Egiptiane, se i neverite mëkatat e paganizmës, dhe u-bëre anëtare e çëmuar e Kishës, me lutje dhe me përkorë, dhe me agjërime përmi natyrën

njerëzore; përandaj u-lartësove më Krishtin, me jetën dhe me vepërimet, edhe fitove Mbretërinë, o Nënë Oshënare, Mari e ndriçime.

Gjithë sot, të Dielën e Pestë të Kreshmëve, kujtojmë Shën Marinë, Nënë tonë Oshënare.

Me nërmjetimet e saj, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Pastaj Zbritësoret: "Ja gojën e çel tani." Pas Dërgimësore Ngjallësore, këndohen:

DERGIMESORET, T. III PAS EPESKEPSATO IMAS

Për pendimin na tregon, udhën më të shigurtë; nërmjeto pra që dhe ne, t' arrijmë në shpëtim si ti, më kreshmë dhe me agjërim, me lutje dhe me vepra, me mall me besë dhe shpresë.

Embëlsi e Engjëjve, gëzim i të helmuarve, streh' e të Krisherëve, o Nën' e lumur e Krishtit; shpëtona prej mëkatave, përkrahna dhe dhurona, Parajsën e Engjëjve.

LAVDERIMET

Këndohen Vargëzimet e Tingëllit, edhe Lavdia e ditës:

LAVDI, T. I. Mbretëria e Perëndisë nuk është e ngrënë dhe e pirë, po drejtësi dhe përkorë me shenjtërim; përandaj të pasurit nukë do të hyjnë brënda përveç atyre, që mbledhin thesare dyke mëshiruar të varfërit. Këto mësimë na jep, edhe Profeti David i cili na thotë. I drejtë është ay që mëshiron, që gëzohet më Zotin, dhe baret në dritë, dhe ay nukë do të pengohet. Pra le të

pendohemi, le të agjërojmë, dhe le të bëhemi të drejtë. Dhe Perëndia na dhëntë të mirat e qjellit për të mirat e dheut.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë.

Doksollogjia e Madhe. Në Hyrjen Përlëshorja e Tingëllit, e Shën Marisë Egjiptiane, dhe Shkurtorja "Përlufteshës Gjenerale".

APOSTULLI

Adhurojeni dhe lavdërojeni Zotin Perëndinë tonë. Perëndia është i njohur në Jude.

Këndimi prej Letrës së Palit për Hebrenjtë.

Vëllezër, Krishti ardh si Kryeprift i të mirave të pritme me një formë më të lartë dhe më të mbaruar, e cila nuk ishte e gatuar me dorë njeriu, dhe nuk ishte e kësaj krijese, pastaj hyri një herë në Shenjtëroren, dhe na dha çpërblimin me gjakun e vetë dhe jo me gjakun e cepinjve dhe viçërve. Se nëqoftëse gjaku i demave dhe i cepinjve dhe hiri i mishqerrave i spërkat të kunguarit, edhe ua paqëson trupet, ahëre gjaku i Krishtit, i cili e blatoj veten përpara Perëndisë me anën e Shpirtit të Shenjtë, do ta paqësonjë ndërgjegjen tonë ca më tepër nga veprat e vdekura për të adhuroar Perëndinë e gjallë.

UNGJILLI PAS MARKUT

Më atë kohë, Jesuj mori mënjane të dymbëdhjetë dishepujtë, dhe nisi t'u tregonte ato, që i kishin për të ngjarë: "Se ja, tani ngjitemi në Jerusalem, edhe i Biri i njeriut do të përripet në duart' e Kryepriftërinjve dhe

të Shkronjësve, dhe do ta përhapin në duart' e Gjentilëve; dhe do ta përqeshin, dhe do ta pështyjnë, dhe do të ngjallet më ditën e tretë.” Edhe Jakobi dhe Joani, të bijtë e Zebedeut, iu-afruan, dhe i thanë: “Mësonjës, duam të na mbarosh një lutje.” Dhe Jesu i pyeti: “Ç' lutje doni tju mbaronj?” Dhe ata iu-përgjeqnë: “Duam të rrimë njëri më të djathtë dhe tjetri më të mëngjër të lavdisë sate.” Dhe Jesuj u tha: “Nukë dini se ç' lypni. A muntni të pini kupën, që pi unë, dhe të pagëzoheni me pagëzimin, që pagëzohem unë?” Dhe ata iu-përgjeqnë: “Mundim.” Dhe Jesuj u tha: “Kupën, që pi unë, do ta pini, dhe me pagëzimin, që pagëzohem unë, do të pagëzoheni, po për të ndënjur më të djathtën dhe më të mëngjërën time, nuk e kam në dorë tjuja jap, se kjo do tu jipet atyre, për të cilët është gatitur.” Dhe kur e dëgjuan të dhjetët e tjerë, nisnë të zëmërohëshin kundër Jakobit edhe Joanit. Edhe Jesuj i thirri dhe u tha: “E dini se ata, që i sundojnë Gjentilët, janë të zotërit e tyre, dhe të mëdhenjtë e tyre kanë fuqi mi ta. Po për ju nukë do të jetë kështu. Po kush të donjë të bëhet i pari juaj do të jetë robi të gjithëve. Se i Biri i njeriut nuk ardhë të shërbehet, po të shërbenjë, dhe të japë shpirtin si çpërblim për popullin.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit.